



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Rr. Xhorxh Bush, Nr. 31, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +383 38 244 183 / 244 186 | E-mail: rektorati@uni-pr.edu

Ueb: www.uni-pr.edu

Nr. Prot: 334

Datë: 6 / 2 / 2026

Senati i Universitetit të Prishtinës, bazuar në kompetencat e përcaktuara sipas nenit 20 dhe në zbatim të neneve 106, 107 dhe 108 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 28.01.2026, mori këtë:

### V E N D I M

për plotësim dhe ndryshim të Vendimit me nr. prot. 198 të datës 07.02.2025, mbi kohëzgjatjen e afatit për përfundimin e studimeve për studentët e nivelit bachelor, master dhe doktoratë

- I. Pika III e Vendimit me nr. prot. 198 të datës 07.02.2025, mbi kohëzgjatjen e afatit për përfundimin e studimeve për studentët e nivelit bachelor, master dhe doktoratë të Senatit të Universitetit të Prishtinës, ndryshohet dhe plotësohet me këtë përmbajtje:
  - Studentët e nivelit bachelor dhe master, të cilët kanë tejkaluar dyfishin e kohëzgjatjes së studimeve dhe i kanë përfunduar të gjitha provimet sipas programit studimor, por ndodhen ende vetëm në procesin e mbrojtjes së temës së diplomës, kanë të drejtë ta përfundojnë procesin e diplomimit përfundimisht deri më 14 shtator 2026.
- II. Ky afat vlen vetëm për studentët e nivelit bachelor dhe master, të cilët kanë përfunduar të gjitha provimet dhe nuk kanë obligime të tjera akademike.
- III. Të gjitha dispozitat tjera të Vendimit të Senatit të Universitetit të Prishtinës të datës 07.02.2025, të cilat nuk preken nga ky plotësim-ndryshim, mbesin në fuqi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Senati i Universitetit të Prishtinës dhe zbatohet për vitin akademik 2025/'26.

#### T'u dërgohet:

1. Njësive akademike;
2. Menaxhmentit të UP-së;
3. Departamentit për Çështje Ligjore;
4. Parlamentit Studentor;
5. Arkivit të UP-së.



Kryesuesi i Senatit të UP-së,

*Arben Hajrullahu*  
Prof. Arben Hajrullahu, Rektor.